# AKTI I THEMELIMIT

## TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## *"FORMULA" SH. P. K.*

### NENI 1 - EMERTIMI I SHOQERISE

Prej shtetasve:

- ***MATENTZIADIS AVRAAM***, lindur ne Athine me 17.06.1961 (GREQI) dhe rezident ne adresen: Naksu, 5 – Qesariani (Athine – Greqi); me shtetesi dhe kombesi greke;
- ***VLADIMIROS SKURA***, i biri i Ganiut dhe i Hurmase, lindur ne Librazhd me 03.01.1973 dhe banues ne Vlore ne adresen: lagje "Uji i Ftohte", prane Vila Nr.2; me shtetesi dhe kombesi shqiptare,

eshte themeluar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "***FORMULA***" ***sh.p.k***.

### NENI 2 - QENDRA E SHOQERISE

Shoqeria "***FORMULA.***" sh.p.k. do te kete qendren ne Vlore ne adresen: lagje "Pavarsia", rruga "Kosova", kulla Nr.2 ndertuar nga "SKELA KONSTRU KSION" Shpk dhe do te kete te drejte te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.
Shoqeria mund te krijoje agjensi, zyra perfaqsimi, qendra dytesore ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte Shtetit.

### NENI 3 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte caktuar ne masen 100.000 (njeqindmiej) lek dhe eshte teresisht kapital financiar i depozituar prej ortakeve themelues ne raportet:

- MATENTZIADIS AVRAAM 70%
- VLADIMIROS SKURA 30%

Kapitali eshte i ndare ne 100 kuota me vlere 1.000 (njemije) leke secila.
Me vendim te Asamblese se ortakeve kapitali mund te rritet ne format te parashikuara nga ligji.

## NENI 4 - KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin per nje periudhe prej 20 vjetesh. Ajo do te jete subjekt i te drrejtes shqiptare qe nga data e regjistrimit te saj dhe do te ushtroje veprimtarine e saj deri me 31.12.2025.
Me vendim te Asamblese se ortakeve ky afat mund te zgjatet ose shoqeria mund te shkrihet para ketij afati.

## NENI 5 - OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti I veprimtarise se shoqerise do jete vijuesi:

- *Tregtim me shumice e pakice, montim e mirembajtje per: mjetet e mbrojtjes kunder zjarrit; sisteme mbrojtese kunder zjarrit; sisteme parandaluese nga vjedhjeve per ambiente banesa (apartamente e vila) dhe ambiente sherbimi (zyra, dyqane, etj); mjete mbrojtese per punonjesit e sektoreve te ndryshem;*
- *aktivitet ne fushen e sherbimeve*; aktivitet ne fushen e hotelerise, hapja e bar – restoranteve e picerive; servis automjetesh; agjensi sherbimesh;
- *Aktivitet ne fushen e tregtise*. tregtimi me shumice dhe pakice i artikujve te ndryshem industriale dhe ushqimore; materialeve te ndertimit; pajisjeve hidrosanitare, elektrike dhe elektroshtepiake; pjeseve te kembimit per automjete, pajisje zyrash; import – eksporti i tyre;
- *aktivitet ne fushen e transportit*, per vehte dhe per llogari te treteve; transporte nacionale dhe internacionale; transport mallrash dhe pasagjeresh;
- *shoqeria po ashtu mund te bashkepunoje me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te ndryshem nga i saj.*

## NENI 6 - ORGANET DREJTUESE

Administrator i shoqerise do te jete ortaku VLADIMIROS SKURA

Shoqeria "FORMULA" sh.p.k. do te jete subjekt I te drejtes shqiptare dhe do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne pergjithesi dhe me normat e aktit themelues dhe te statutit bashkangjitur.

Ky akt themelimi nenshkruhet prej ortakeve themelues ne date 25.10.2005, pasi me pare aktet iu jane lexuar ne greqisht prej perkthyeses Zj. Marjeta MERKURI, ne prezence te Noteres JETMIRA VERAJ.

*ORTAKET THEMELUES:*

*1.* AVRAAM MATENTZIADIS *2.* VLADIMIROS SKURA

**3.** Perkthyesja e gjuhes greke

Vlore me, njezete e pese tetor dymije e pese.

# S T A T U T I

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## *"FORMULA " SH. P. K.*

## EMERTIMI-OBJEKTI-QENDRA-KOHEZGJATJA

### NENI 1

Prej shtetasve:

- *MATENTZIADIS AVRAAM*, lindur me 17.06.1961 ne Athine (GREQII) dhe rezident ne adresen: Naksu, 5 – Qesariani (Athine – Greqi); me shtetesi dhe kombesi Greke;

dhe

- *VLADIMIROS SKURA*, i biri i Ganiut dhe i Hurmase, lindur ne Vlore me 03.01.1973 dhe banues ne Vlore ne adresen: lagje "Uji i Ftohte" , prane Vila Nr.2; me shtetesi dhe kombesi shqiptare,

eshte themeluar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar te quajtur" ***FORMULA***" ***sh.p.k.***

### NENI 2

Shoqeria "***FORMULA.***" sh.p.k. do te kete qendren ne Vlore ne adresen: lagje "Pavaresia", rruga "Kosova", kulla Nr.2 ndertuar nga "SKELA KONSTRU-KSION" Shpk dhe do te kete te drejte te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.
Shoqeria mund te krijoje agjensi, zyra perfaqsimi, qendra dytesore ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

### NENI 3

Shoqeria do te ushtroje aktivitet per nje periudhe prej 20 vjetesh. Ajo do te jete subjekt I te drejtes shqiptare qe nga data e regjistrimit te saj dhe do te ushtroje veprimtarine e saj deri me 31.12.2025.
Me vendim te Asamblese se ortakueve te vetem ky afat mund te zgjatet ose shoqeria te shkrihet para ketij afati.

## NENI 4

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj sa vijon:

- *Tregtim me shumice e pakice, montim e mirembajtje per: mjetet e mbrojtjes kunder zjarrit; sisteme mbrojtese kunder zjarrit; sisteme parandaluese nga vjedhjeve per ambiente banesa (apartamente e vila) dhe ambiente sherbimi (zyra, dyqane, etj); mjete mbrojtese per punonjesit e sektoreve te ndryshem;*
- *aktivitet ne fushen e sherbimeve*; aktivitet ne fushen e hotelerise, hapja e bar – restoranteve e picerive; servis automjetesh; agjensi sherbimesh;
- *Aktivitet ne fushen e tregtise*: tregtimi me shumice dhe pakice i artikujve te ndryshem industriale dhe ushqimore; materialeve te ndertimit; pajisjeve hidrosanitare, elektrike dhe elektroshtepiake; pjeseve te kembimit per automjete, pajisje zyrash; import – eksporti i tyre;
- *aktivitet ne fushen e transportit*, per vehte dhe per llogari te treteve; transporte nacionale dhe internacionale; transport mallrash dhe pasagjeresh;
- *shoqeria po ashtu mund te bashkepunoje me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te ndryshem nga i saj.*

## KAPITALI I SHOQERISE

## NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte caktuar ne masen 100.000 (njeqindmije) lek dhe eshte teresisht kapital financiar i depozituar prej ortakeve themelues. Kapitali eshte I ndare ne 100 kuota me vlere 1.000 (njemije) leke secila. Ortaket themelues MATENTZIADIS AVRAAM dhe VLADIMIROS SKURA kane nenshkruar kapitalin ne raportet vijuese:

- MATENTZIADIS AVRAAM nenshkruan 70% te kapitalit, ekuivalente me 70 kuota kapitali me vlere 70.000 leke (shtatedhjetemije);
- VLADIMIROS SKURA nenshkruan 30% te kapitalit, ekuivalente me 30 kuota kapitali me vlere 30.000 leke (tridhjetemije).

Me vendim te Asamblese se ortakeve kapitali mund te rritet.

## NENI 6

Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme prej ortakeve themelues, persa i perket shitjes se kuotave tek te tretet kjo ortake mund te behet vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqsojne te pakten 3/4 e kapitalit themeltar.

Ne rast se shoqeria nuk njofton vendimin e saj ose refuzon te jape miratimin per kete transferim, do te respektohen normat e parashikuara nga neni 47 I ligjit 7638 date 19.11.1992.

## ASAMBLEA E ORTAKEVE

### NENI 7

Asamblea e ortakeve eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise ku marrin pjese te gjithe ortaket e shoqerise.
Ne kuptim te ligjit asamblea eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme.

### NENI 8

Çdo ortak ke te drejten e nje vote per çdo kuote qe disponon.
Asamblea thirret prej Administratorit te shoqerise ose kur e kerkojne ortaket qe perfaqesojne te pakten 1/10 e kapitalit te shoqerise.
Thirrja e asamblese se ortakeve do behet me leter rekomande drejtuar seicilit ortak prej Administratorit ne vendbanimin e tij te paket 15 dite para mbledhjes.
Jane te vlefshme edhe mbledhjet e asamblese se ortakeve qe nuk jane thirrur duke respektuar proceduren e mesiperme, por ne te cilat marrin pjese te gjithe ortaket.

### NENI 9

E drejta e pjesmarrjes ne Asamble u takon te gjithe ortakeve.
Çdo ortak ka te drejten te perfaqesohet ne mbledhjet e asamblese nga nje person tjeter ortak ose jo ortak, nepermjet prokures noteriale.

### NENI 10

Vendimet e asamblese se zakonshme merren me shumice te thjeshte votash. Persa i perket ndryshimeve te statutit, rritjes apo zvogelimit te kapitali, shkarkimit dhe emerimit te administratorit, duhet aprovimi i ortakeve qe perfaqesojne te pakten 3/4 e kapitalit.

## ADMINISTRIMI

### NENI 11

Shoqeria administrohet prej nje administratori. Administrator i shoqerise do te jete,ortaku VLADIMIROS SKURA.

## NENI 12

Administratori ka fuqi te gjera ne drejtimin dhe administrimin e zakonshem te veprimtarise se shoqerise, duke patur te drejten te kryeje tere aktet e nevojshme te ketij administrimi.
Administratori eshte perfaqsuesi I shoqerise tek institucionet dhe te tretet dhe çdo veprim i kryer prej tij brenda kompetencave dhene ne aktin e emerimit, eshte i detyrueshem per shoqerine.

## BILANCI DHE TE ARDHURAT

## NENI 13

Viti fiskal mbyllet ne daten 31 dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo viti fiskal administtratori kryen procedurat per redaktimin e bilancit social te te ardhurave, humbjeve dhe shpenzimeve.
Fitimi neto, pasi hiqet prej tij rezerva ligjore prej 5%, i kalon ortakuit te vetem. Ne raste nevoje per financime dhe investime te reja, me vendim te ortakut te vetem mund te vendoset rritja e kapitalit social.

## SHKRIRJA E SHOQERISE

## NENI 14

Shoqeria mund te shkrihet para afatit te mesiperm me vendim te Asamblese se ortakeve ose kur per kete merret nje vendim gjykate i formes se prere. Ne secilin rast emerohen likuidatoret dhe percaktohen ne aktin e emerimit kompetencat e tyre.

## DISPOZITA TE FUNDIT

Shoqeria ***"FORMULA" sh.p.k.*** do te jete subjekt i te drejtes shqiptare dhe do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne pergjithesi, normat e ketij statuti dhe aktit themelues bashkangjitur.
Ky statut nenshkruhet prej ortakeve themelues ne date 25.10.2005 pasi me pare aktet iu jane lexuar ne greqisht prej perkthyeses Zj. Marjeta MERKURI, ne prezence te ***Noteres JETMIRA VERAJ.***

## ORTAKET THEMELUES:

1. AVRAAM HATZIADIS 2. VLADIMIROS SKURA

**3.** Perkthyesja e gjuhes greke Marjeta Merkuri ____